

**PAGË PËR
PUNË TË
SHTËPISË**

SILVIA FREDERICI

Përktheu në shqip: Trina Binaku nga Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist.

Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist është grup i përbërë nga aktiviste/ë feministe/ë që synon avancimin e idealeve të barazisë gjinore përmes teorisë dhe praktikës feministe. I krijuar mbi parimin e ndërthurjes, kolektivi angazhohet në avancimin e drejtësisë gjinore dhe promovimin e barazisë shoqërore lokale dhe globale.

Me anë të shqyrtimit të historisë, gjinisë, seksualitetit, ekonomisë, shtetit dhe konstrukteve tjera shoqërore, Kolektivi angazhohet në prodhimin e dijeve të kontekstualizuara feministe dhe luftimin e vlerave androcentrike dhe patriarkalizmit. Mbi parimin e vlerësimit të barabartë shoqëror Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist synon grupimin e një mase kritike të aftë për të kundërshtuar dhe luftuar çdo lloj shtypjeje dhe padrejtësie shoqërore dhe institucionale.

Ata thonë se është dashuri, ne themi është punë e papaguar.

Ata e quajnë ftohtësi seksuale, ne e quajmë shmangie të vetëdijshme.

Çdo abort spontan është aksident në punë.

Homoseksualiteti dhe heteroseksualiteti janë që të dyja kushte pune...mirëpo homoseksualiteti është mjet kontrolli i punëtorëve mbi prodhimin...jo përfundimi i punës.

Më shumë buzëqeshje? Më shumë para. Asgjë nuk është më e fuqishme në shkatërrimin e vetive shëruese të një buzëqeshjeje.

Neurozat, vetëvrasjet, deseksualizimi: sëmundje që vijnë si pasojë e punës të një amvise.

Shumë shpesh, vështirësitë dhe paqartësitë që vijnë në pah prej grave kur diskutojnë mbi pagën për punët e shtëpisë vijnë nga thjeshtëzimi i pagës si mjet financiar, sasi parash, në vend të trajtimit të saj nga një perspektivë politike. Dallimi midis këtyre dy këndvështrimeve është jashtëzakonisht i madh. Ta trajtosh pagën për punë të shtëpisë si gjësend e jo si perspektivë, do të thotë ta shkëpusësh qëllimin përfundimtar të luftës nga vetë lufta, duke dështuar kështu të kuptojmë rëndësinë që kjo përpjekje ka në ç'mitizimin dhe përmbysjen e rolit në të cilin shoqëria kapitaliste i ka burgosur gratë.

Kur e vështrojmë pagën për punët e shtëpisë nga ky prizëm reduktues, ne fillojmë dhe pyesim veten: sa do të ishte jeta jonë më ndryshe nëse do të kishim më shumë para? Mbase do të pajtoheshim se për shumë gra që nuk kanë mundësi tjera përveç se të martohen dhe të jenë amvise, këto para do ta bënin ndryshimin. Por, për ne që kemi kushtimisht zgjidhje tjera - punë profesionale, burra të emancipuar, jetë me bazë në komunitet, marrëdhënie gejt - ose një kombinim të këtyre - atëherë kjo pagë nuk do të sillte ndryshim. Për ne që pavarësia ekonomike na mundësohet në forma tjera gjëja e fundit që duam është të identifikohemi si amvise, një fat, për çka të gjitha pajtohemi se, është më i keq se vetë vdekja.

Problemi nga kjo mendësi është se imagjinojmë se posedojmë më shumë para sesa realisht kemi në jetën tonë të pështirë dhe pyesim, për çka? E gjithë kjo mbi premisën e rreme që ne mund të fitojmë pa revolucionarizuar njëkohësisht, përgjatë përpjekjes tonë, të gjitha marrëdhëniet tona në familje dhe në shoqëri. Por nëse e shohim çështjen e pagës për punë të shtëpisë nga një perspektivë politike, do ta kuptojmë se vetë lufta për pagë do të prodhojë revolucion në jetrat tona dhe në pushtetin tonë shoqëror si gra. Gjithashtu, është shumë e qartë se nëse mendojmë se “nuk na duhen” ato para, atëherë ne veçse i kemi pranuar format e veçanta të prostitutimit të trupit dhe mendjes tonë, me pagën e së cilës e shtypim atë nevojë. Ashtu siç do të shtjelloj në vijim, përveç besimit se paga për punë të shtëpisë përbënë një perspektivë revolucionare, në fakt është e vetmja perspektivë revolucionare nga një pikëpamje feministe dhe përfundimisht për gjithë klasën punëtore.

“Një punë dashurie”

Është e rëndësishme të kuptohet se kur flasim për punë të shtëpisë nuk po flasim për to si për punët e tjera të zakonshme por po flasim për një ndër format më shtypëse dhe manipuluese, për dhunën më të përhapur dhe tinëzare që kapitalizmi ka ushtruar ndaj çfarëdo grupi të klasës punëtore. Po, është e vërtetë, se në kapitalizëm çdo punëtorë/e është i/e manipuluar dhe i/e eksploatuar dhe marrëdhënia e tij/saj me kapitalin është gjithmonë e komplikuar. Paga të jep përshtypjen e një marrëveshjeje të drejtë: ti punon dhe paguhesh. Kështu nënkuptohet se ti dhe shefi jeni të barabartë, kur në të vërtetë, paga në vend se të paguhej në përputhje me punën e bërë, ajo vetëm fsheh të gjithë punën e papaguar që përkthehet në fitim. Të paktën puna e njeh faktin se ti je punëtor/e, dhe mund të negociosh dhe të përpiqesh t'i ndryshosh kushtet dhe sasinë e asaj pagese. Duke pasur pagë, ti je pjesë e kontratës sociale, përmbajtja e së cilës nuk vihet në diskutim: ti punon jo se të pëlqen apo se të vjen natyrshëm të punosh por ngaqë puna është i vetmi kusht nën të cilin të lejohet të jetosh. Mirëpo sado i/e shfrytëzuar që të jesh, ti nuk je vetëm puna që bën. Sot je postier/e, nesër shofer/e taksie. E rëndësishme, mbi të gjitha, mbetet se sa punë bën dhe sa para mund të marrësh.

Në rastin e punëve të shtëpisë, situata ndryshon përmbajtësisht. Ndryshimi qëndron në faktin se jo vetëm që punët e shtëpisë imponohen mbi gratë por se ato janë shndërruar në attribute natyrore të fizikut dhe personalitetit femëror, një nevojë e brendësuar, një aspiratë e cila aludohet të vijë nga thellësia e karakterit femëror. Punët e shtëpisë detyrimisht u kthyen në attribute natyrore dhe nuk u përfshinë në kontratën sociale, pikërisht për faktin se që nga fillimi i planit të kapitalit për gruan, kjo punë u mendua si një punë që nuk do të paguhet. Në mënyrë që të pranohet këtë punë të papaguar, kapitalit iu desh të na bindte se kjo punë është një aktivitet i natyrshëm, i pashmangshëm madje edhe shpirtërisht përmbushës. Kështu, mos-pagimi i punëve të shtëpisë rezultoi të jetë arma më e fuqishme në përforcimin e idesë se punët e shtëpisë nuk janë punë, duke mos ua lejuar kështu grave mundësinë për të kundërshtuar, përveçse në revoltat e vogla brenda hapësirës private -dhomë - kuzhinë të cilat përqeshen nga të gjithë,

duke e reduktuar kështu protagonisten e kryengritjes. Neve na shohin si bushtra që vetëm ankohe mi dhe jo si punëtore të shtypura.

Për të parë se sa e natyrshme është të jesh amvise, tregon qartë fakti se duhen të paktën njëzet vite socializim, një trajnim i përditshëm profesional që kryhet nga një nënë e papaguar për ta përgatitur një vajzë për këtë rol, për ta bindur se burri dhe fëmijët janë gjëja më e mirë që mund të presë nga jeta e saj. Përkundër kësaj, vështirë arritet sukcesi. Pa marrë parasysh sa mirë jemi të trajnuara, të pakta janë ato gra që nuk ndihen të mashtruara kur përfundon dasma dhe e gjejnë veten para një lavamani me enë të palara. Disa prej neve ende jetojmë me iluzionin se jemi martuar nga dashuria. Shumë prej neve martohemi për para dhe siguri; por, ka ardhur koha ta kemi të qartë se, ndonëse ka shumë pak dashuri dhe para në këtë mes, punët që na presin nuk kanë fund. Prandaj, gratë më të vjetra na thonë “Shijojeni lirinë përderisa keni mundësi, bleni çka të doni sa keni kohë...” Por, fatkeqësisht është gati e pamundur të shijosh çfarëdo lirie, kur prej një moshe të hershme trajnohesh të jesh e urtë, e nënshtruar dhe e varur dhe mbi të gjitha, e gatshme të sakrifikosh vetveten, e madje edhe të ndjesh kënaqësi nga kjo sakrificë. Nëse nuk të pëlqen, ky është problemi yt, dështimi yt, ndjenja jote e fajit, paaftësia jote.

Duhet ta pranojmë se kapitali ka qenë shumë i suksesshëm në vjedhjen e punës tonë. Ka krijuar një kryevepër të vërtetë në kurriz të grave. Duke na mohuar pagën për punët e shtëpisë dhe duke e transformuar atë në një akt dashurie, kapitali ka vrarë shumë zogj me një gur. Pikë së pari, ka përfitur punë gati se falas dhe është siguruar që gratë, në vend se ta kundërshtojnë, ta shohin këtë punë si gjëja më e mirë në jetë (fjalët magjike: “Po, e dashur, je një grua e vërtetë”). Për më tepër, ka disiplinuar edhe punëtorin burrë - duke e bërë gruan e tij të varur nga puna dhe paga e tij, duke e vënë kështu në kurth ku ai disiplinohet. Atij i ofrohet një shërbëtoreshë pasi që ai vetë ka shërbyer mjaftshëm në fabrikë apo zyre. Në fakt, roli jonë si gra është të jemi të papaguara por të lumtura, mbi të gjitha shërbëtoreshë të sjellshme të “klasës punëtore”, pra asaj shtrese të proletariatit të cilit kapitali i ka dhënë më shumë pushtet shoqëror. Ashtu siç zoti krijoi Evën për t’i dhënë kënaqësi Adamit, ashtu edhe kapitali krijoi amviset për t’u shërbyer fizikisht,

emocionalisht dhe seksualisht punëtorëve burra — t'i rrisë fëmijët e tij, t'i arnojë çorapet e tij, t'ia përkëdhelë egon e nëpërkëmbur nga puna dhe nga marrëdhëniet shoqërore (thelbi i të cilave është vetmia) që kapitali ka krijuar për të. Është pikërisht ky kombinimi i veçantë i punës fizike, emocionale dhe seksuale që përfshihet në performancën e gruas kundrejt kapitalit që e bën aq pozicion specifik atë të të qenurit amvise, barra e së cilës është aq e madhe sa edhe e padukshme. Nuk ndodhë rastësisht që burrat fillojnë të mendojnë për martesë në momentin kur fillojnë të punojnë për herë të parë. Jo vetëm se tash ata mundën ta përballojnë financiarisht një gjë të tillë por se të pasurit dikë në shtëpi që kujdeset për ta është e vetmja mënyrë që të mos çmenden pas një ditë pune në vijën e prodhimit ose në tavolinë. Çdo grua e dinë së kjo është ajo çfarë duhet bërë për të qenë një grua e vërtetë dhe të kesh një martesë të “suksesshme”. Në raste të tilla, sa më e varfër që të jetë familja, aq më i shprehur do të jetë skllavërimi i gruas dhe kjo jo vetëm se qëndrojnë keq financiarisht. Në fakt, kapitali ka standarte të dyfishta, një për klasën e mesme dhe një për familjen proletare. Jo rastësisht shohim maçizmin më të ashpër në familjet e klasës punëtore: sa më shumë përbuzje që burri përjeton në punë aq më shumë gruaja trajnohet t'i përmbrëndësojë ato, kështu ai e shëron më shpejt egon e tij përmes shtypjes se saj. Ti e rreh gruan dhe gurron zemërimin tënd drejt saj kur je i frustruar dhe i rraskapitur në punë, ose je mposhtur në ndonjë sfidë (vetë shkuarja në fabrikë në vetvete është mposhtje). Sa më shumë që burri shërben dhe është i shtypur, aq më shumë ai shtypë. Shtëpia e një burrit është kështjella e tij...dhe gruaja e tij duhet të mësojë dhe të presë në qetësi kur ai është i zemëruar, t'ia kthejë disponimin dhe kur është duke e mallkuar botën, të kthehet në anën tjetër ne shtrat kur ai thotë “Jam shumë i lodhur sonte” ose kur bën seks me nguti - dhe e bën ata, siç do të thoshte një grua, më mirë do ishte ta bënte me një kavanoz me majonez. (Gratë gjithmonë kanë gjetur mënyra të luftojnë, të hakmirren por gjithmonë brenda hapësirave private dhe të izoluar. Problemi pra mbetet tek ajo se si ta nxjerrim këtë revoltë jashtë kuzhinës dhe dhomës së gjumit, në rrugë).

Kjo farsë që na shfaqet në emër të dashurisë dhe martesës na ndikon të gjithave, edhe nëse nuk jemi të martuara sepse në momentin kur punët e

shtëpisë u natyralizuan dhe u seksualizuan, kur kjo çështje iu atribua feminitetit, të gjitha ne gratë u asociuam me të. Nëse është normale që në të bëjmë disa punë të caktuara, atëherë pritet që të gjitha gratë t'i bëjnë të njëjtat punë - për më tepër t'iu pëlqejnë - duke përfshirë edhe ato gra që për shkak të statusit shoqëror mund t'i shmangen disa punëve ose edhe të gjithave (kur burrat e tyre mund të punësojnë shërbëtore dhe terapistë dhe t'ju ofrojnë forma tjera të relaksimit dhe kënaqësisë). Ndoshta ne nuk i shërbejmë një burri te caktuar por të gjitha jemi në një marrëdhënie të shërbëtore me të gjithë botën e burrave. Për këtë arsye, të të quajnë grua është ofenduese, cilësim degradues (Buzëqesh, zemër, çfarë problemi ke?" është një pyetje që çdo burrë ndjen se ka të drejtë të të pyes, qoftë ai bashkëshorti yt, burri që të kontrollon biletën ose shefi në punë).

Perspektiva revolucionare

Nëse e vështrojmë çështjen e pagës për punë të shtëpisë nga kjo analizë, do të shohim se lufta për pagë për punë të shtëpisë ka implikime revolucionare. Me këtë kërkesë i jepim fund natyrës tonë dhe e fillojmë luftën tonë kundrejt saj sepse të duash thjesht pagë për punët e shtëpisë do të thotë të refuzosh këtë punë si shprehje e natyrës sonë dhe rrjedhimisht ta refuzosh pikërisht rolin femëror që kapitali ka shpikur për ne. Duke kërkuar pagë për punë të shtëpisë do të kundërshtojmë pritshmëritë që shoqëria ka ndaj nesh, pasi që këto pritshmëri, të cilat janë esenca e socializmit tonë, janë në shërbim të kushteve ku nuk paguhemi mbrenda shtëpisë. Në këtë kuptim, është absurde të krahasosh luftën e grave për pagë me atë luftë të burrave për pagë më të madhe mbrenda fabrikës. Lufta e punëtorit për pagë më të lartë sfidon rolin e tij shoqëror mirëpo prapë se prapë qëndron brenda tij. Kur ne kërkojmë pagë për punë të shtëpisë, në kundërshtojmë pikërisht vetë rolin tonë shoqëror. Në të njëjtën mënyrë se si ka dallime përmbajtësore midis luftës së një punëtori me pagë kundrejt luftës së një skllavi për pagë kundër skllavërisë. Por duhet të jetë e qartë se kur kërkojmë pagë, ne nuk po kërkojmë të hymë brenda sistemit kapitalist sepse në fakt kurrë s'kemi qenë jasht këtij sistemi. Ne luftojmë që të shkatërrojmë planin e kapitalit për gratë, sepse ky plan është ai që bën ndarjen e punës dhe pushtetit shoqëror brenda klasës punëtore, përmes të cilit kapitali mirëmban pushtetin e tij. Kështu,

lufta për pagë për punë të shpisë jo vetëm që është kërkesë revolucinare që do të shkatërrojë kapitalizmin por do të sulmojë kapitalin dhe do ta detyrojë të ristrukturojë marrëdhëniet shoqërore në atë formë që për ne do të jetë më e favorshme, rrjedhimisht edhe më e favorshme për unifikim të klasës punëtore. Në fakt, të kërkuar pagë për punë të shtëpisë nuk do të thotë se nëse fillojmë të paguhemi do të vazhdojmë t'i kryejmë këto punë por nënkupton pikërisht të kundërtën. Duke thënë se duam para për punë të shtëpisë ne bëjmë hapin e parë drejt refuzimit të plotë të kryerjes së punëve të shtëpisë. Vetëm duke kërkuar pagë, puna jonë do të vërehet e që është parakushti kryesor në luftën kundër punës, në aspektin e punëve brenda shtëpisë por edhe kundër karakterit të tyre monstruz si punë që i takojnë virtytit femëror.

Përkundër akuzave të “ekonomizimit” ne duhet të kujtojmë se paraja është kapital dhe rrjedhimisht ka fuqinë të kontrollojë punën. Pra duke përvetësuar ato para që janë fryti i punës të nënave dhe gjysheve tona njëkohësisht do të thotë të minimizosh pushtetin e kapitalit për të kontrolluar punën tonë. Gjithashtu nuk duhet të mashtrohemi nga pushteti i parasë në ç'mitizimin e feminitetit tonë duke vë në pah atë feminitet në punë, pasi që mungesa e pagës ka qenë aq e shkathët në formësimin e atij roli dhe fshehjes së punës tonë. Duke kërkuar pagë për punë të shpisë në e bëjmë të qartë se mendjet tona, trupat tanë, ndjenjat tona janë shtrembëruar me një qëllim specifik dhe na është imponuar një model ndaj të cilit ne duhet të përshtatemi nëse duam të pranohemi si gra në shoqëri.

Kur themi se duam pagë për punë të shtëpisë ne shpërfaqim faktin se punët e shtëpisë tashmë gjenerojnë para për kapitalin, atë kapital që ka përfituar dhe përfiton nga gatimet dhe buzëqeshjet tona, nga qirja jonë. Në të njëjtën kohë kjo tregon se kemi gatuar, buzëqeshur e jemi qirë gjithë këto vite, jo pse e bëjmë më lehtë se tjerët por sepse nuk kemi pasur zgjidhje tjetër. Fytyrat tona janë shtrembëruar prej buzëqeshjes së tepërt, ndjenjat tona janë venitur duke dashuruar shumë, tejsksualizimi jonë na ka lënë totalisht të deseksualizuara.

Paga për punët e shtëpisë është vetëm fillimi. Por, mesazhi është i qartë: tash e tutje do të paguhemi sepse ne si gra nuk garantojmë më për asgjë. Duam ta quajmë punë atë që është punë që ndërkohë të rizbulojmë së çka është dashuria dhe të formsojmë atë që do të quhet seksualiteti jonë, të cilin asnjëherë nuk e kemi njohur. Kur flasim nga këndvështrimi i punës, ne mund të kërkojmë jo vetëm një pagë por shumë paga, sepse jemi detyruar të kryejmë shumë punë në të njëjtën kohë. Ne jemi amvise, punëtore seksi, infermiere, psikologe; ky është thelbi i idesë së bashkëshortes “heroike” që festohet në “Ditën e nënës”. Ne themi: mjaft festuat eksploatimin tonë, heroizimin tonë të supozuar. Prej tash e tutje, ne duam para për çdo minutë të harxhuar duke punuar në shtëpi, në mënyrë që të fillojmë të refuzojmë disa punë, dhe përfundimisht të gjitha. Në këtë kuptim, asgjë tjetër s’do të ketë efekt më të madh sesa të tregojmë se virtytet tona femërore kanë një vlerë monetare të kalkulueshme që deri sot i kanë shërbyer kapitalit i cili ka përfituar duke na shtypur; dhe nga sot e tutje do të jenë vetëm *në shërbimin tonë*, kundër kapitalit, dhe në përputhje me forcën tonë të organizimit.

Lufta për shërbime sociale

Kjo është perspektiva më radikale që mund të përqafojmë edhe dhe pse mund të kërkojmë për çkado, çerdhe, pagë të barabartë, lavanderi papagesë. kjo pasiqë ne nuk do të arrijmë asnjë ndryshim të njëmend nëse nuk e kundërshtojmë rrënjësisht rolin tonë femëror. Lufta jonë për shërbime sociale si kushte më të mira pune gjithmonë do të jetë ë pamjaftueshme nëse fillimisht nuk e njohim punën tonë si punë. Përderisa nuk e kundërshtojmë punën në shtëpi në tërësinë e saj, ne kurrë nuk do të korrim fitore brenda saj. Do të dëshojmë për të siguruar lavanderitë pa pagesë nëse fillimisht nuk kundërshtojmë idenë se mund të dashurojmë vetëm nëse punojmë pafund, proces i cili dita ditës shkatërron trupat tanë, seksualitetin tonë, marrëdhëniet tona shoqërore. Duke mos u shantazhuar nga nevoja për të dhënë dhe për të marrë dashuri e cila përdoret kundër nesh si çështje pune ku urrejme bashkëshortin, fëmijët tanë dhe shoqërinë, e më pas ndihemi ne faj për urrejtjen që ndiejmë. Punësimi në ndonjë punë dytësore nuk bën ndryshimin, gjë që është dëshmuar prej punës së grave ndër vite. Puna e dytë jo vetëm që forcon eksploatimin tonë por edhe riprodhon rolin tonë

në forma tjera të ndryshme. Kudo që shohim, vërejmë se punët që gratë i bëjnë janë vetëm vazhdim i kushteve të punëve të shtëpisë me të gjitha nuancat e saj. Kështu, jo vetëm se bëhemi infermiere, shërbëtoresh, mësuese, sekretare -të gjitha funksionet për të cilat jemi trajnuar në shtëpi -por përjetojmë edhe të njëjtat kufizime si në shtëpi sikurse është izolimi, fakti se jeta e njerëzve tjerë varet nga ne ose pamundësia të kuptojmë se kur fillon dhe mbaron puna jote, ku mbaron puna jonë dhe fillojnë dëshirat tona. Atëherë kur i sjellim shefit tonë një kafe dhe flasim me të për problemet e tij në martesë, a është kjo punë e sekretares ose një favor personal? A janë kushtet e punës në pyetje apo karakteri femëror kur shqetësohemi për mënyrën se si dukemi? (Deri vonë, stjuardeset në Shtetet e Bashkuara Bashkuara të Amerikës peshoheshin rregullisht dhe duhej të mbanin vazhdimisht dietë, torturë kjo që e njohin të gjitha gratë, nga frika se mos pushoheshin nga puna). Siç edhe thuhet shpesh, kur tregu i punës kërkon prezencën e një gruaje “Një grua mund të bëjë çfarëdo punë dhe të mos humbas feminitetin e saj”, që thjesht do të thotë se pavarësisht se çfarë pune bën, prap se prap do të mbetesh veç një pidi.

Sa i përket propozimeve të socializimit dhe të kthyerit punët e shtëpisë në punë kolektive, janë dy shembuj që bëjnë dallimin midis këtyre mundësive dhe perspektivës tonë. Mundësia që të ndërtojmë një çerdhe sipas dëshirave tona dhe të kërkojmë që shteti të paguaj për të është një gjë, mirëpo është krejt diçka tjetër nëse ia dorëzojmë fëmijët tanë shtetit dhe kërkojmë nga shteti t’i kontrollojë ata, t’i disiplinojë, t’i mësojë ta nderojnë flamurin amerikan jo vetëm për pesë orë por për njëzet e katër orë. Ne mundemi të organizohemi në komunitete dhe ta planifikojmë mënyrën sesi ushqehemi dhe të kërkojmë nga shteti të paguajë për të por është diçka krejt e kundërt të kërkojmë nga shteti të na ushqejë. Në rastin e parë ne fitojmë kontroll minimal mbi jetra tona, në rastin e dytë ne fuqizojmë kontrollin e shtetit mbi ne.

Lufta kundër punëve të shtëpisë

Disa gra thonë: si do të arrijë paga për punë të shtëpisë të ndryshojë sjelljen e burrave tanë drejt nesh? Me siguri burrat tonë do të vazhdojnë të kërkojnë

të kryhen të njëjtat punë, e ndoshta edhe të tjera tash që paguhemi? Por këto gra kanë dështuar të shohin se pikërisht për faktin se nuk paguhemi ata kërkojnë kaq shumë nga ne sepse ata presupozojnë se kjo është “punë për gra” që nuk kërkon shumë mund. Burrat i pranojnë këto shërbime dhe përjetojnë kënaqësi nga to sepse mendojnë se punët e shtëpisë i bëjmë me lehtësi, kënaqësi dhe nga dashuria. Ata zakonisht presin që ne të jemi falenderuese për faktin se ata janë martuar dhe jetojnë me ne, dhe po na mundësojnë që të performojmë si gra, që në fakt nënkupton t’ju shërbejmë atyre. “Je me fat që ke gjetë një burrë sikur unë”. Vetëm atëherë kur burrat fillojnë të na e njohin punën si punë, dashurinë si punë dhe më e rëndësishmja të na njohin kundërshtimin tonë kundrejt të dyja këto, atëherë do të fillojnë të ndryshojnë sjelljen e tyre ndaj nesh. Kur qindra e mijëra gra dalin në rrugë dhe thonë se pastrojnë pafundësisht, janë gjithmonë të qasshme emocionalisht, kryejnë akte seksuale me forcë nga frika se mund të humbasin punën, se e gjithë kjo është një punë, e vështirë, e urryer, që po na e çon jetën dëm, vetëm atëherë burrat do të frikësohen dhe do të ndihen të dobët. Por kjo është gjëja më e mirë që mund të ndodhë nga perspektiva jonë. Duke shpërfaqur mënyrën se si kapitali na ka mbajtur të ndarë (kapitali ka disiplinuar ata përmes neve dhe neve përmes atyre, për njëri tjetrin dhe kundër njeri tjetrit). Ne, patericat dhe skllavet e tyre, përmes zingjirëve të tyre do të hapim rrugën për çlirimin e tyre. Në këtë kuptim, paga për punë të shtëpisë do të jetë shumë më edukative, do të shkojë përtej idesë se mund ti kryejmë punët sikur burrat, se mund të punojmë të njëjtat punë. Këtë do t’ua lëmë “grave të karrierës”, atyre që mundohen t’i ikin shtypjes, jo përmes fuqisë së organizimit dhe luftës por përmes pushtetit të zotëriut, pushtetit që zakonisht shtyp gra tjera. Nuk kemi nevojë të dëshmojmë se mund “t’i mposhtim pengesat e vëna nga jakat e kaltërta”. Shumë prej nesh i kemi mposhtur ato pengesa shumë kohë më parë, dhe kemi kuptuar se komishonet nuk na kanë dhënë më shumë pushtet se përparsja, e që në shumë raste ka dhënë më pak, sepse ne u detyruam ti veshim që të dyja, kështu nuk kishim mjaftushëm kohë dhe energji të luftojmë kundër tyre. *Ne dubet ta dëshmojmë vetëm kapacitetin tonë për ta bërë të dukshme punën tonë, atë shtypje që kapitali ushtron mbi ne, dhe forcën tonë për ta luftuar.*

Fatkeqësisht, shumë gra e sidomos gratë beqare frikësohen nga ideja e pagës për punë të shtëpisë sepse tremben nga ideja se mund të identifikohen si një amvise. Ato e dijnë se ky është pozicioni me më pak pushtet në shoqëri dhe nuk e kanë kuptuar ende se ato vetë tashmë janë amvise. Kjo është edhe e meta e tyre, një e metë e cila mirëmbahet dhe shpërfaqet përmes mungesës të një vetë-identifikimi. Ne duam dhe duhet të themi se te gjitha jemi amvise, punëtore seksi dhe të gjitha jemi gej. Përderisa nuk e njohim skllavërimin tonë, ne nuk mund ta shtrojmë luftën tonë kundër tij. Përderisa mendojmë se jemi diçka “më e mirë”, diçka më ndryshe nga amviset ne pranojmë logjikën e zotëriut që është logjikë e ndarjes, dhe për ne logjikë e skllavërisë. Ne të gjitha jemi amvise sepse pa marrë parasysh se ku jemi gjithmonë do të këtë më shumë punë për në, më shumë frikë nga ana jonë për të vokalizuar kërkesat tona, më pak presion mbi ta për të na paguar, duke shpresuar se vëmendja jonë është diku tjetër, në atë burrin që në të tashmën apo në të ardhmën do të “kujdeset për ne”.

Ne gjithashtu mashtrojmë veten duke menduar se mund t'i evitojmë punët e shtëpisë. Por sa nga ne, përkundër punës jashtë shtëpisë, kemi shpëtuar pa i përfunduar? A mundemi gjithashtu të mohojmë idenë e bashkëjetesës me një burrë? Çka nëse pushohemi nga puna? Çka kur fillojmë të plakemi dhe humbasim pushtetin minimal që rinia (riprodhimi) dhe bukuria (riprodhimi femëror) na ofron sot? E fëmijët? A do të pendohemi ndonjë ditë për faktin se kemi vendosur mos të kemi fëmijë? Madje duke mos pasur as mundësinë ta shtrojmë realisht këtë pyetje? A mund ti përballojmë marrëdhëniet gej? A jemi të gatshme të pagujmë çmimin e izolimit dhe përjashtimit? Por, a mundemi në fakt të përballojmë marrëdhëniet me burra?

Pyetja është kjo: pse janë këto të vetmet mundësi dhe cila luftë do të na mundësojë tjera?



KOLEKTIVI PËR MENDIM DHE VEPRIM
FEMINIST

1 MAJ 2021